

VENDIM
Nr. 610, datë 31.8.2016

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E KULTURËS DHE “ALBA FILM”, SHA, TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË ZONËN KADASTRALE NR. 8130

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Kulturës te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pasurisë së paluajtshme me emërtimin “Lulishte”, në zonën kadastrale nr. 8130, me indeks harte TR-I, J-17, 18 dhe nr. 4/88 pasurie, me sipërfaqe 2000 (dy mijë) m² truall (ish-Kinostudio), sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga “Alba Film”, sh.a., te Ministria e Arsimit dhe Sportit, të pasurive të paluajtshme në zonën kadastrale nr. 8130, me indeks harte TR-I, J-17, 18, me sipërfaqe 1906.5 (një mijë e nëntëqind e gjashtë pikë pesë) m² truall dhe sipërfaqe 1575.1 (një mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë një) m² objekt (ish-Kinostudio), sipas planvendosjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk mund ta tjetërsojë apo ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Kulturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama